



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2025

VENDIM

Nr. 818, datë 04.12.2025

**PËR
PROPOZIMIN PËR EMËRIM NË GJYKATËN E LARTË,
TË KANDIDATIT Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 04.12.2025, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e tij nr. 178, datë 11.05.2022, bazuar në rezultatet e procedurës së përzgjedhjes, si dhe mbasi shqyrtoi projektvendimin “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit z. {...}”,

V Ë R E N:

I. MBI PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË TË GJYQTARIT

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli), sipas pikës 1, të nenit 136, si dhe shkronjës “c”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është organi kushtetues i ngarkuar me funksionin e propozimit Presidentit të Republikës të emërimit të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, nga radhët e gjyqtarëve dhe të juristëve të spikatur. Ky funksion i Këshillit të Lartë Gjyqësor, përcaktohet edhe në pikën 2, të nenit 85, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka përcaktuar procedura të detajuara që ndiqen nga Këshilli për këtë qëllim.
2. Emërimi në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), konsiderohet si ngritje në detyrë, çka përbën një nga institutet juridike të zhvillimit

të karrierës gjyqësore, përgjegjës për të cilën është Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 86 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Neni 48 i Ligjit për Statusin përcakton se çdo pozicion i lirë në një gjykatë të një shkalle më të lartë ose të specializuar, plotësohet nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, nëse, kur është rasti, ky pozicion nuk arrihet të plotësohet nëpërmjet lëvizjes paralele. Në rastin e Gjykatës së Lartë, referuar kuptimit dhe përmbajtjes së institutit juridik të lëvizjes paralele, ky instrument ligjor është i pazbatueshëm, sa kohë Gjykata e Lartë është gjykata e shkallës më të lartë në piramidën e organizimit të pushtetit gjyqësor, sikurse përcaktohet në pikën 1, të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, po ashtu edhe në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Në kuadër të një procedure ngritjeje në detyrë, përfshirë edhe atë të emërimit në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 48, të Ligjit për Statusin, Këshilli i Lartë Gjyqësor është i ngarkuar me përgjegjësinë e verifikimit të plotësimit nga kandidatët të kriterëve të kandidimit. Këshilli, deri në propozimin për emërimin në Gjykatën e Lartë ndjek një sërë hapash proceduralë pas kualifikimit të kandidatëve siç janë: vlerësimi etik dhe profesional dhe renditja e kandidatëve që plotësojnë kriteret, në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart.
4. Në përmbushje të përgjegjësiave të tij për zhvillimin e karrierës gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka miratuar aktet nënligjore kryesore të autorizuara nga ligji.
- 4.1 Me Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli plotësoi kuadrin ligjor në lidhje me procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore edhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, përfshirë dhe për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, që përbën dhe fazën e parë të procedurës së ngritjes në detyrë.
- 4.2 Me Vendimin nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli plotësoi kuadrin ligjor në lidhje me procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve, që përfshin renditjen e tyre dhe zgjedhjen e kandidatit të renditur më lart, për ta propozuar në pozicionin e lirë ku ka kandiduar.
- 4.3 Në funksion të renditjes së kandidatëve, Këshilli gjithashtu ka miratuar Vendimin nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, si dhe Vendimin nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, nëpërmjet të cilëve plotësoi kuadrin ligjor në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve.

5. Këshilli, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Ky veprim është ndërmarrë me synim përmbylljen në kohë të pozicioneve të lira, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Lartë, për plotësimin e kësaj të fundit me numrin e plotë të anëtarëve të saj. Për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit, që janë: i) *“përvoja profesionale minimale”*; ii) *“mospasja masë disiplinore në fuqi”*; dhe iii) *“mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale”*, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kriterë do të duhej të skualifikohej paraprakisht nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional. Në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Pas verifikimit të kriterëve formalë të kandidimit, si edhe kriterëve të pasurisë dhe figurës, Këshilli vendos përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë.

II. PROCEDURA E NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 178, DATË 11.05.2022, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuar nga ligji, siç u përmend në pika 4.1- 4.3 të këtij vendimi, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës) dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës), për plotësimin e pozicioneve të lira në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, ndër të tjera, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë edhe për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e tij nr. 178 datë 11.05.2022.
7. Në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 178 datë 11.05.2022, afati i kandidimit u përcaktua *“tre javë nga dita e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*. Ky vendim u publikua në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 11.05.2022, krahas edhe një njoftimi publik. Pas këtij publikimi, nga dita e nesërme e tij, ka filluar të ecë afati i kandidimit, duke përfunduar ai pas më 01.06.2022.

A. KANDIDIMET

8. Brenda afatit të kandidimit, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 178 datë 11.05.2022, kandiduan gjithsej 8 (tetë) kandidatë dhe konkretisht: znj. {...}, Znj. {...}¹, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}², z. {...} dhe z. {...}³.

B. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

9. Procedura e verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit nga kandidatët për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 178 datë 11.05.2022, filloi me Vendimin e tij nr. 220 datë 20.06.2022 *“Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me nr. 178, datë 11.05.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*.
10. Fillimisht, sikurse u përmend në pikën 5 të këtij vendimi, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga secili kandidat të kriterëve formale të kandidimit, pikërisht të:
- 1) *“përvojës profesionale minimale”*. Ky kriter parashikohet në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si edhe në pikën 5, të nenit 47, të Ligjit për Statusin;
 - 2) *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”*. Ky kriter parashikohet në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin;
 - 3) *“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”*. Ky kriter parashikohet në nenin 8, të Ligjit për Statusin.
11. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak të 3 (tre) kriterëve formale të kandidimit, fillimisht, Këshilli konstatoi dhe vlerësoi plotësimin nga 8 (tetë) kandidatët të këtyre kriterëve, duke vendosur vijimin e procedurës së verifikimit për kriterin e pasurisë dhe figurës.
12. Këshilli verifikoi plotësimin nga kandidatët të 3(tre) kriterëve formale të kandidimit dhe vendosi vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore (pasurisë dhe figurës) të kandidimit.
- 12.1 Verifikimi i plotësimit të kriterëve formale për kandidatët u vendos nga Këshilli:

¹ Kandidatja {...} në përfundim të procedurës së përzgjedhjes të kryer nga ana e Këshillit, me vendim nr. 458 datë 25.07.2023, është propozuar për t'u dekretuar nga Presidenti i Republikës për pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021 (vendim nr. 458 datë 25.07.2023.)

² Këshilli, me vendimin nr. 709 datë 03.12.2024, ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për këtë kandidat, pas shfaqjes së vullnetit të tij për tërheqjen nga ky pozicion.

³ Këshilli, me vendimin nr. 121 datë 06.03.2024 ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për këtë kandidat, pas shfaqjes së vullnetit të tij për tërheqjen nga ky pozicion.

- a) me vendimin nr. 355 datë 27.05.2022 për kandidaten znj. {...};
- b) me vendimin nr. 366 datë 13.09.2022 për kandidatin z. {...};
- c) me vendimin Nr. 507 datë 21.11.2022 për kandidatin z. {...};
- d) me vendimin nr. 365 datë 13.09.2022 për kandidaten znj. {...};
- e) me vendimin Nr. 356 datë 27.05.2022 për kandidaten znj. {...};
- f) me vendimin Nr. 367 datë 13.09.2022 për kandidatin z. {...};
- g) me vendimin Nr. 506 datë 21.11.2022 për kandidatin z. {...};
- h) me vendimin Nr. 511 datë 21.11.2022 për kandidatin z. {...}

13. Në vijim, Këshilli verifikoi plotësimin nga secili prej kandidatëve edhe të kriterëve “të pasurisë dhe figurës”, sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji”, si dhe: “8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

14. Në përfundim të procedurës së verifikimit, Këshilli konstatoi dhe vlerësoi plotësimin nga të 7(shtatë) kandidatët e tjerë të të gjithë kriterëve të kandidimit, duke vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë.

14.1 Kualifikimi i 7(shtatë) kandidatëve dhe vijimi për ata të procedurës së ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, u vendos nga Këshilli:

- a) me vendimin nr. 510 datë 21.11.2022 për kandidaten znj. {...};
- b) me vendimin nr. nr. 83 datë 16.02.2023 për kandidatin z. {...};
- c) me vendimin nr. 525 datë 06.12.2022 për kandidatin z. {...};
- d) me vendimin nr. 175 datë 05.05.2022 për kandidaten znj. {...};
- e) me vendimin nr. 509 datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...};
- f) me vendimin nr. 508 datë 21.11.2022 për kandidatin z. {...};
- g) me vendimin nr. 100 datë 19.02.2025 për kandidatin z. {...};

14.2 Për kandidatin {...}, me vendimin nr. 99, datë 19.02.2025, Këshilli vendosi *skualifikimin dhe përjashtimin e tij nga procedurat e emërimin në Gjykatën e Lartë*, në kushtet kur për të u verifikua mosplotësimi i kriterit të pasurisë “*gjendja e konfliktit të interesit*”. Kandidati paraqiti ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, dhe kjo e fundit me vendimin nr. 73, datë 23.06.2022 vendosi rrëzimin e padisë.

Ç. PROCEDURAT E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL

15. Nga ana tjetër, siç u parashtrua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët e kualifikuar Këshilli ka vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional. Konkretisht: 1) Procedura e vlerësimit me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të

Ligjit për Statusin, filluar me Vendimin e Këshillit nr. 198, datë 11.06.2020; 2) Procedura e vlerësimit të përshpejtuar për vitin 2021 për kandidatët, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr.48/2019;

16. Në përfundim të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional, Këshilli ka miratuar për secilin nga katër kandidatët e mbetur në garë të cituar më sipër, vlerësimet etike dhe profesionale për periudhat respektive të vlerësimit. Konkretisht:

- a) për kandidatin z. {...}, vlerësimet etike dhe profesionale u miratuan me Vendimet e Këshillit nr. 667, datë 02.11.2023 dhe 729, datë 07.12.2023;
- b) për kandidaten znj. Valbona Vata, vlerësimet etike dhe profesionale u miratuan me Vendimet e Këshillit nr. 58, datë 15.02.2022 dhe nr. 687, datë 14.11.2023;
- c) për kandidatin z. Rexhep Bektashi, vlerësimet etike dhe profesionale u miratuan me Vendimet e Këshillit nr. 307, datë 06.06.2023 dhe nr.615, datë 17.09.2025;
- ç) për kandidatin z. Petrit Çomo, vlerësimet etike dhe profesionale u miratuan me Vendimet e Këshillit nr. 368, datë 13.09.2022 dhe nr. 683, datë 14.11.2023.

D) PROCEDURA E PËRZGJEDHJES

17. Këshilli, me Vendimin nr. 520, datë 06.12.2022 filloi procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e tij nr. 178 datë 11.05.2022, duke përcaktuar edhe relatorin e procedurës.

18. Në përfundim të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 178 datë 11.05.2022, bazuar në kriteret e renditjes të përcaktuara në pikën 9, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara më tej në Vendimin e Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, dalë në zbatim të pikës 14, të nenit 48, të këtij ligji, Këshilli realizoi renditjen e kandidatëve, duke identifikuar kandidatin e renditur më lart, i cili, sipas ligjit, duhet të propozohej për emërim. Konkretisht, me Vendimin nr. 786, datë 06.11.2025, Këshilli miratoi Vendimin Paraprak të Propozimit për Emërim duke vendosur:

“1. Miratimin e renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 178 datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) Z. {...};
- 2) Znj. {...}; Z. {...}
- 3) Z. {...}

2. Propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 178 datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidatit z. {...}.

18.1 Gjatë procedurave së përzgjedhjes, kandidatja znj. Vojsava Kola kishte kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021. Për këtë kandidate, në përfundim të procedurës së përzgjedhjes, Këshilli, ka miratuar renditjen e kandidatëve me Vendimin nr. 315, datë 14.06.2023, ku kandidatja znj. {...} rezultoi e para në renditje dhe është propozuar për emërim në Gjykatën e Lartë përkatësisht në pozicionin nr. 536, datë 17.11.2021 (tashmë dekretuar edhe nga Presidenti i Republikës si anëtare e Gjykatës së Lartë). Në këto rrethana ajo nuk është përfshirë në procedurën e renditjes.

19. Vendimi nr. 786, datë 06.11.2025 iu njoftua rregullisht, kandidatëve z. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}. Kandidatët bazuar në pikën 12, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, gëzonin të drejtën e ankimit brenda 5 ditëve, nga njoftimi i tij.

20. Referuar kthim -përgjigjes së Gjykatës Administrative të Apelit datë 26.11.2025, rezulton se ndaj vendimit të mësipërm nuk është ushtruar ankim, si i tillë Vendimi Paraprak i Propozimit për Emërim nr. 786, datë 06.11.2025, ka marrë formë të prerë më datë 25.11.2025.

III. MBI PLOTËSIMIN E KRITEREVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT NË GJYKATËN E LARTË, NGA KANDIDATI Z. {...}

21. Siç u parashtrua, plotësimi i kriterëve të kandidimit nga kandidati z. {...}, u verifikua nga Këshilli me Vendimin nr. 507 datë 21.11.2022 (për tre kriteret formale të kandidimit) dhe, më pas, edhe me Vendimin final nr. 525 datë 06.12.2022.

22. Konkretisht, për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi i kriterit të “*përvojës minimale profesionale*”. Për verifikimin e këtij kriteri janë administruar: informacione nga e rrethit gjyqësor Shkodër, Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e Apelit Tiranë, si edhe Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

23. Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati plotëson kriterin e përvojës së përgjithshme minimale profesionale, ndërsa ai ka ushtruar funksionin e gjyqtarit për më shumë se 13 vjet. Kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 29.06.1994. Me vendim nr. 1, datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet ndihmësgjyqtar

efektiv në Gjykatën e Rrethit Malësi e Madhe. Referuar Vërtetimit datë 20.04.2009 të Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Z. {...} nga data 01.07.1998 ka ushtruar funksionin e ndihmësgjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pas transferimit për shkak të suprimimit të Gjykatës së Rrethit Malësi e Madhe. Me vendim nr. 18, datë 29.07.1998 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me dekret nr. 4247, datë 11.06.2004 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Me vendim nr. 207, datë 07.02.2007 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pas shqyrtimit të kërkesës për lirim nga detyra pas zgjedhjes anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lirohet nga detyra e gjyqtarit. Me dekret nr. 6571, datë 19.05.2010 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, tashmë Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.

23.1 Po për kriterin e *“përvojës minimale profesionale”*, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati plotëson edhe përvojën specifike minimale profesionale, ndërsa ai ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në fushën e të drejtës penale, për më shumë se 5 vjet. Përvojën specifike profesionale kandidati e ka në gjykatat ku ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

24. Për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi edhe i kriterit të *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”*. Për verifikimin e këtij kriteri janë administruar: informacioni datë 30.06.2022, i Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Formulari i Vetëdeklarimit *“Për masa disiplinore”*, datë 27.05.2022, depozituar nga kandidati në momentin e kandidimit, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”*.

24.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati nuk ka masë disiplinore në fuqi.

25. Për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi edhe i kriterit të *“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”*. Për verifikimin e këtij kriteri është administruar Formulari i Vetëdeklarimit *“Për situatën e papajtueshmërisë ambientale”*, datë 27.05.2022, depozituar nga kandidati në momentin e kandidimit, ku ka deklaruar se *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

25.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati nuk do të ndodhej në situatën e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit për Statusin, nëse do të ngrihej në detyrë/emërohej në Gjykatën e Lartë.

26. Për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi edhe i kriterëve të “pasurisë” dhe të “figurës”.

26.1 Për këto kriterë, në nenin 48, pikat 7 dhe 8, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”. Ky përcaktim ligjor në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrë, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Lartë, është rregulluar më tej në aktin nënligjor të Këshillit, Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar. Verifikimi i pasurisë dhe figurës për z. {...} është bërë sipas përcaktimeve ligjore të mësipërme.

26.2 Pasur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë subjekt rivlerësimi kalimtar “*ex officio*”, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar që kandidonin për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. Kështu, në këtë akt nënligjor, Këshilli parashikoi rregulla specifike edhe për gjyqtarët që kandidonin për ngritjen në detyrë, të cilët i ishin nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe ishin konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë.

26.3 Konkretisht, në Seksionin B, Kreu X, të vendimit 75/2019, të ndryshuar, përcaktohet se: “1. Kandidatët subjekt rivlerësimi kalimtar, të cilët janë konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë të organeve të rivlerësimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe figurës sipas përcaktimeve të Ligjit për Statusin dhe të këtij vendimi, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për periudhën e rivlerësimit kalimtar, vendimi i Këshillit mbështetet në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit. 2. Për kandidatët subjekt rivlerësimi kalimtar, për të cilët nuk ka filluar ose nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar, Këshilli i Lartë Gjyqësor kërkon shqyrtimin me përparësi të këtij procesi ndaj tyre. Për këta kandidatë fillon verifikimi i pasurisë dhe figurës sipas përcaktimeve të Ligjit për Statusin dhe të këtij vendimi, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Procedura e verifikimit përmbyllet mbas dhe në varësi të mënyrës së përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar. 3. Marrja e masës disiplinore sipas neneve 60 dhe 61, të Ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përbën shkak për skualifikimin dhe përjashtimin nga procedurat e ngritjes në detyrë të kandidatëve subjekt rivlerësimi kalimtar”.

Sa më sipër, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për t'u kualifikuar për ngritjen në detyrë, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjin 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", sikundër edhe procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas nenit 32 të Ligjit për Statusin, kjo për periudhën pas asaj të rivlerësimit kalimtar dhe deri në momentin e kandidimit.

27. Për verifikimin e kriterit të "*pasurisë*" janë administruar: Vendimi nr. 286, datë 04.08.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe është bërë përfundimtar pas shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, me vendimin nr. 30 datë 11.10.2021. Për rrjedhojë, verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidat u shtri për periudhën 30.01.2017 deri më datë 14.07.2022. Akti i Përfundimit të Kontrollit të Plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Private të Kandidatit për Institucionet e Sistemit të Drejtësisë nr. 825/24 prot., datë 18.10.2022, i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Interesave Privatë; Shkresa nr. 11293/1 prot., datë 07.07.2022, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3680/4 prot., datë 12.07.2022 e Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve dhe Shkresa nr. 12442/1 prot., datë 08.07.2022, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3708/7 prot., datë 12.07.2022, e Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave.

27.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati ka kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjin 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", referuar për këtë Vendimit nr. 30, datë 11.10.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

27.2 Po ashtu, për këtë kriter, sa i përket periudhës pas asaj të rivlerësimit kalimtar dhe deri në momentin e kandidimit, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se:

- a) *kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;*
- b) *kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;*
- c) *kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;*
- ç) *deklarimi nga kandidati i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.*

28. Për verifikimin e kriterit të "*figurës*" janë administruar: shkresat nga shërbimet shtetërore informative; Shkresa nr. 3587/1 prot., datë 27.06.2022, e strukturës së posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

28.1 Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar, sikurse u përmend, është konstatuar se kandidati ka kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

28.2 Po ashtu, për këtë kriter, sa i përket periudhës pas asaj të rivlerësimit kalimtar dhe deri në momentin e kandidimit, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se për kandidatin nuk identifikohet dhe verifikohet ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

28.3 Në vijim, për këtë kriter, në kushtet kur kandidati ka qenë magjistrat/gjyqtar në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidati i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Struktura e posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me Shkresën nr. 3587/1 prot., datë 27.06.2022, ka konfirmuar se:

- kandidati ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 29.04.2016;
- formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web-it;
- në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji;
- deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

28.4 Kandidati iu nënshtrua gjithashtu verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, në kushtet kur ai është i vitlindjes më të hershme se Korrik 1977 (kandidati është i vitlindjes 1970), sikurse përcaktohet në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të vendimit 75/2019. Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. 1245/5 prot., datë 21.07.2022, Vendimin nr.319 datë 21.07.2022, me të cilin është vendosur: “Të informojë institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 3776 prot., datë 01.07.2022, “Kërkesë për verifikim”, të pastërtisë së figurës, përpara emërimit të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën e Lartë , se nga verifikimet e kryera deri tani për z.{...} nuk rezulton: a) të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991, në zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas përcaktimeve të nenit 29 të Ligjit nr.45/2015

“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit të Statusit, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit, përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e tij, mbi të cilat mund të gjykohej për pranueshmërinë ose jo të tij për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

IV. KONKLUZIONE

29. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidati z. {...}, në kushtet kur plotëson kriteret e kandidimit për emërim në Gjykatën e Lartë, ndërsa është kandidati i renditur më lart në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e tij nr. 178, datë 11.05.2022 duhet t’i propozohet Presidentit të Republikës për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në nenin 147 dhe në shkronjën “c”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 2, të nenit 85 dhe në shkronjën “ë”, të nenit 86, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 11, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun IX, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I:

1. T'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. {...}.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR